



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË PARË

Numri i lëndës: 2021:043588  
Datë: 30.12.2024  
Numri i dokumentit: 06664667

K.DH.SH.II.nr.468/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES - Dhomat e Shkalles se Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjiellësi “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, rr. Hazir Shala 4, ndaj debitorit Blerim “Te Ramizi” Gerxhaliu 2, me seli ne Lipjan rr. “Komandant Kumanova”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1249/22 dt.29.11.2023, me datë 30.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Regjionale Ujësjiellësi “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, rr.Hazir Shala nr.4, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1249/22 dt. 29.11.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1249/22 dt. 29.11.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Blerim “Te Ramizi” Gerxhaliu 2, me seli ne Lipjan rr. “Komandant Kumanova”, ndërsa urdhrin për përmbarim P.nr.56/21 dt.22.01.2021, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Arsim I. Bajraktari, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes se dispozitave te procedurës civile, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rishqyrtim ose aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe prapësimin e debitorit ta refuzoj.

Dhoma e shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale Ujësjetlësi “Prishtina” sh.a me seli ne Prishtinë, rr. Hazir Shala nr.4, me datën 05.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Blerim “Te Ramizi” Gerxhaliu 2, me seli ne Lipjan rr. “Komandant Kumanova”, në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifrën 107587. Përmbartuesi Privat Arsim I. Bajraktari me seli ne Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lejuar përmbartimin me urdhrin përmbartimor P.nr.56/2021 dt.22.01.2021, me të cilën ka obliguar debitorin që kreditorit në emër të borxhit për shërbimet publike-furnizim me ujë te pijshëm, t’ia paguajë shumën prej 1,481.59 euro, ne afat prej 7 ditësh, si edhe shpenzimet e përmbartimit ne emër te kompensimit te shpenzimit për përmbartuesin privat.

Ndaj këtij urdhri përmbartimor, debitori ka ushtruar prapësim me datën 10.02.2021, me pretendim se debitori nuk është pronar e as nuk e ka te regjistruar ne emër te tij por ne baze te dhënave ne ARBK dhe asnjëherë nuk është marrë me veprimtarinë e cekur ne propozim, ashtu qe kemi te bëjmë me pasaktësi te propozim për përmbartim, Tutje ka theksuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar ngase llogaritja e borxhit është bërë nga viti 2013. I ka propozuar gjykatës që të anulohet propozimi dhe urdhëri përmbartimor, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj propozimin për përmbartim dhe kreditori ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, të pa argumentuar si dhe të pa mbështetur në ligj dhe prova. E ka kundërshtuar deklarimin e debitorit lidhur me parashkrimin pasi që debitori ka pranuar borxhin e tij dhe njëkohësisht ka bërë pagesa të pjesshme dhe se pasqyra financiare e debitorit ka cilësinë e dokumentit të besueshëm te titullit ekzekutiv. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të hedhet poshtë si i pa bazuar dhe i pa argumentuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1249/22 dt.29.11.2023, me te cilin ka vendosur si ne dispozitiv te aktvendimit. Gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi. Vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist 107587, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par.1 të LPP-së, i cili parasheh qe Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se

“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”. Në rastin konkret gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi Privat ka lejuar përmbardimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit nuk evidentohet saktësisht në ekstraktin nga librat afarist. Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 107587, rezulton se borxhi në shumën prej 1,481.59 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 19.01.2021, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç’ rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë, andaj pasi që gjykata vlerësoi se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbardimor në rastin konkret, nuk i ka tiparet e dokumentit të besueshëm si dhe nuk ka tipare të përmbardueshmërisë, si rrjedhojë nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, duke vendosur kështu si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkalles së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkalles së Dytë, po ashtu vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbardim, në bazë të dokumentit dhe atë Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit nr.107587 konform nenit 29 par.1 nenpar.1.2 të LPP në baze të cilit dokumente të besueshme janë edhe *Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*, sipas të cilit kreditori kërkon borxhin ndaj debitorit për periudhën prej 01.01.2013 deri me 19.01.2021 me shumën prej 1,481.59 euro.

Gjykata e shkalles së parë me të drejtë ka vlerësuar se ky dokument mbi bazën e të cilit është lejuar përmbardimi nuk plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar si dokument i ekzekutueshëm konform nenit 29 par.3 i LPP i cili përcakton se “Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, sepse analizuar të njëjtin rezulton se ky ekstrakt, nuk e ka të përfshirë periudhën kohore prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç

‘rast është e paqartë se shuma e detyrimit e kërkuar nga kreditori ndaj debitorit për cilën periudhë saktësisht ka të bëjë dhe se cili është saktësisht detyrimi i debitorit ndaj kreditorit, e kjo sepse me datën 31.12.2013 detyrimi i debitorit ndaj kreditorit është ne shumen prej 244.23 euro, ndërsa ne propozimin për përmbarim nuk është definuar saktë periudha kohore për të cilën kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori. Pra është e paqartë se borxhi i kërkuar nga kreditori për cilën periudhë kohore ka të bëjë.

Andaj bazuar ne këto arsye edhe kjo gjykatë vlerëson se përfundimi juridik i gjykatës e shkalles se parë është i drejtë dhe i bazuar dhe se të njëjtin e pranon ne tërësi edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimin e kreditorit se gjykata e shkalles e parë nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se e njëjta ka bere shkelje te dispozitave ligjore, nuk qëndron sepse ne rastin konkret është i paqartë borxhi i kërkuar nga kreditori me theks te veçante faktin se ekstrakti i verifikuar nga librat afaristë te kontabilitetit ne këtë rast nuk përfshinë periudhën kohore nga date 01.01.2013- 30.12.2013, ku dihet se kërkesa e kreditori si datë fillestare nga e cila kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori përcakton datën 01.01.2013. Përkitazi kësaj çështje gjykata e shkallës se dytë vlerëson nenin 43 par.4 te LPP përkitazi shfuqizimit te urdhrin përmbarimor. Kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet tjera te kreditorit por te njëjtat i vlerësoi si jo relevante për një vendosje ndryshe, ashtu qe i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e shkalles se parë e vërtetoi.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.468/24, me datë 30.12.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova